



## Plani I mesimit (SYLLABUS)

Institucionioni	Faculteti Ekonomik Prishtine		
<b>Subject :</b>	<b>Menaxhment</b>		
Niveli I studimeve	Bachelor		
Statusi I lendes	zgjedhore		
Viti I studimeve	II		
Numri I ECTS	6		
Departmenti	Management \$ Marketing		
Viti akademik	2019/20		
<b>Profesori</b>	Profesori I lendes:	Prof. Dr. Ymer Havolli	
	Zyra :	Fakulteti Ekonomik, kati VI-numer 66	
	Orari për këshilla për studentë:	Hene, Marte , merkurey 11:30-13:30	
	Telefon:	+383(0)49/400-102	
	E-mail	<a href="mailto:ymer.havolli@uni-pr.edu">ymer.havolli@uni-pr.edu</a>	
<b>MJetodologjia:</b>	Ligjerata , ushtrime, diskutim interaktiv, ese, studime rasti		
<b>Niveli studimeve:</b>	Bachelor <input type="checkbox"/>		
Ngarkesa e studenteve (numri I oreve ne semester, ECTS)			
<b>Aktiviteti</b>	Numri I oreve te ligjeratave	jave	Totali
Ligjerata	2	13	26
Ushtrime	1	15	15
Teste	2	2	4
Zhvillimi I punimeve seminarike	4	3	12
Puna e pavarur e studentit ( library, ship)			95
Pune finale	3	1	3
Total			<b>150</b>

## 1. Përshkrimi i lëndës

Lënda " Manaxhiment " është lëndë, e cila në zhvillohet në vitin e tretë të Fakultetit të Ekonomikë. Kjo lëndë ju jep studentëve konceptet dhe njohuritë themelore të manaxhimit, të cilat janë të domosdoshme për çdo student pavarësisht nga drejtimi të cilin e kanë të zgjedhur.

Nepermjet kësaj metarie studentet do të njihen me bazat e menaxhmentit si shkencë dhe si profesion. Afarizmi bashkëkohor dhe rrethinene e tij organizative. Ekzistimi i bizneseve , mbijetesa, zhvillimi, dhe rritja do t'ishte shumë i vështirë nëse nga ana e menaxhmentit të këtyre bizneseve nuk mirren me kohë vendime të përshtatshme të cilat u mundësojnë atyre të përballojnë konkurrencën dhe mbijetojnë dhe zhvillohen në rrethinën ekonomike ku ato operojnë.

Përveç kësaj studentët do të kenë rastin që të njihen dhe përvetësojnë proceset menaxherike dhe menaxhmentin fazat kryesore të menaxhmentit

(planifikimi, organizimi, udhëheqja dhe kontrolli), si dhe; vendimet e rëndësishme afariste; objektivat, strategjitë politikat dhe planet .

## 2. Qëllimet e lëndës

- Ti pajisë studentët me njohuritë bazë mbi rolet dhe funksionet e një menaxheri në një organizatë biznesi.
- Të analizojë në mënyrë të detajuar mjedisin në të cilin operojnë organizatat me qëllim që vendimet menaxheriale të jenë me një nivel të lartë efektiviteti menaxherial.
- Të orientojë studentët që të dinë të përdorin në mënyrë racionale teknikat ndihmëse në funksion të përmirësimit të cilësisë së manaxhimit.
- Ta aftësojë studentin që njohuritë e fituara gjatë këtij kursi t'i përdore në funksion të formimit të tij dhe njëkohësisht të orientojë me sukses në praktikën e biznesit.

## 3. Rezultatet e pritura

- Pas përfundimit të këtij moduli, studentët do të jenë në gjendje:
- Të njohin zhvillimin historik të menaxhmentit dhe organizimit të punës
  - Zhvillojnë dhe organizojnë menaxhmentin
  - Kuptojnë veçoritë kryesore të menaxhmentit bashkëkohor
  - Marrin vendime menaxheriale
  - Komunikoj, organizoj dhe planifikoj kontrollin Bazat e planifikimit si aktivitetet I procesit menaxherik

## 4. Metodologjia

Lënda zhvillohet në 15 javë me ngarkesë 3 orë ligjerata në të cilat do të trajtohen konceptet teorike dhe do të ipen sqarime lidhur me procesin e menaxhmentit, si dhe dhe 2 orë ushtrime në grupe në javë . Ushtrimet do të zhvillohen në formë me grupe në të cilat do të diskutohen shembuj konkret. Kjo mënyrë e organizimit të ushtrimeve do t'ju shërbejë studentëve për të përvetësuar në mënyrë logjike konceptet teorike dhe për ta lidhur në mënyrë organike teorinë me aspektet praktike të aktivitetit të biznesit.

Studentët do të nënshtrohen **një provimi kontrolli gjatë vitit (testi)** dhe **një provimi përfundimtar në mbarim të ciklit të plotë** të kursit të kësaj lënde.

## 5. Literatura në gjuhën shqipe dhe angleze

[1] Berim Ramosaj Bazat e Menaxhment, Prishtinë

[3] Shyqri LLACI "Teste, Ushtrime dhe Raste Studimore" 2006

[4] Stephen Robins & Mary Coulter, "Management", Prentice Hall, 2007

Cole, G. A: Management: Theory and practice , DP Publications Ltd, Hants, v. 1998.

## 9. Metodatat e vlerësimit

Vlerësimi i studentit do të jetë me shkrim. Pyetjet formulohen prej materialit të specifikuar sipas kapitujve në planin mësimor i cili sipas javëve do të ligjerohet gjatë semestrit.

- Pjesëmarrje aktive, 10 % të notes finale.
- Zhvillimi dhe prezantimi i punimit seminarik, 10% të notes finale.
- Dy kollokviume që përfaqesojnë 100% të notes finale. Kollokviumi i parë përfshin rreth 50% të materialit mësimor, dhe pjesa tjetër në kollokviumin e dytë 50%.
- Nëse studenti kalon dy kollokviumet, provimi është i plotësuar.
- Nëse studenti nuk ka kaluar ndonjërin nga kollokviumet, i nënshtrohet provimit final.

Kollokviumet organizohen 2 herë brenda vitit. Në kollokvium kanë të drejtë studentët të cilët e kanë ndjekur ligjeratat me rregull.

Ndërkaq studentët që për arsye të ndryshme nuk kanë qenë të rregullt i nënshtrohen provimit final. Student i cili ka dhënë kollokviumin e parë, ka të drejtë t'i nënshtrohet kollokviumit të dytë. Nëse nuk kalon në kollokviumin e parë student do t'i nënshtrohet provimit final.

Provimi final: për të kaluar testin e përgjithshëm, studentet duhet që të arrijnë së paku 51% të pikeve të parapara.

Koment: nëse nuk arrihet pragu i kalueshmërisë prej 51%, nuk merret parasysh pjesëmarrja aktive në klase e as punimi seminarik.

Konsultimet me studentët do të mbahen sipas orarit të publikuar në webfaqe dy herë në javë.

Profesori i lëndës  
Ymer Havolli